

Hapet thirrja për aplikime për bursa në Universitetin e Poitiers, Francë, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus +.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për mësimdhënie në Universitetin e Poitiers në Francë, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2022 – 2023.

<https://www.univ-poitiers.fr/en/>

Llojet e mobilitetit:

-Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

Fushat e shkëmbimit:

- Personel akademik që drejton / përgjigjet / mbulon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe kërkimin shkencor, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja;
- Gjuhë frënge;
- Gjuhë gjermane;
- Gjuhë angleze.

<https://www.univ-poitiers.fr/en/>

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 ditë +2 ditët e udhëtimit;

Mobiliteti duhet të kryhet në periudhën shkurt 2023.

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin për stafin (160 EUR në ditë për stafin);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV + Lista e publikimeve;
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi;
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo më parë mobilitet Erasmus+ (nëse po, ku);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing-1-1.docx

*Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Afati për aplikim: **16 Janar 2023**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!